



Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerrë:

## **VENDIM SHPJEGUES PUBLIK NR. 5 / 2014 TRAJTIMI TATIMOR I PËRFITIMEVE NË NATYRË SHUJTAVE PËR TË PUNËSUARIT**

### **QËLLIMI**

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është të sqaroj detyrimet tatimore, mënyrën e deklarimit dhe pagesës së Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, Tatimit në të Ardhurat Personale dhe Tatimit në të Ardhurat e Korporatave, për tatimpaguesit që japin përfitime në natyrë – shujta për të punësuarit e tyre.

### **PËRKUFIZIMET**

Për qëllimin e këtij Vendimi Shpjegues Publik, përkufizimet në vijim, kanë këtë kuptim:

**TVSh** - Tatimi mbi Vlerën e Shtuar i cili përfshinë aplikimin e tatimit të përgjithshëm në konsum për mallra dhe shërbime, që është saktësisht proporcional me çmimin e mallrave dhe shërbimeve. TVSh llogaritet në këtë çmim sipas normës së aplikueshme, ngarkohet në fazat e ndryshme të prodhimit, shpërndarjes dhe ciklit jetësor të tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, dhe që në fund bartet nga konsumatori i fundit.

**Punëdhënës** - çdo person i cili paguan rroga dhe përfshinë:

- një autoritet publik;
- një organizatë biznesi;
- një njësi të përhershme të jo rezidentëve sikur që është definuar sipas Legjislacionit mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave;
- një organizatë jo qeveritare;
- një organizatë ndërkombëtare;
- një qeveri të huaj; dhe
- një person fizik i cili paguan rroga gjatë rrjedhës së zhvillimit të biznesit në Kosovë.

**I Punësuar** - një person fizik i cili kryen punë kundrejt pagesës sipas urdhrorit dhe nën kontrollin e një punëdhënësi, pa marrë parasysh nëse puna është kryer në bazë të kontratës, ndonjë marrëveshje të formës tjetër, qoftë me shkrim apo e pashkruar.

**Furnizim i tatueshëm** - çdo furnizim me mallra ose shërbime të bëra në mbështetje të çdo veprimtarie ekonomike të zhvilluar në Kosovë, e që nuk është një furnizim i liruar.

**Furnizim i liruar** - çdo furnizim të mallrave ose shërbimeve të bëra në mbështetje të çdo aktiviteti ekonomik të zhvilluar në Kosovë, për të cilin personi i tatueshëm – furnizuesi nuk e ka të drejtën të ngarkojë konsumatorin ose blerësin me TVSh.

**Pagat** - kompensimi financiar ose llojet e tjera të kompensimit, duke i përfshirë mallrat, bonuset, favorët, shërbimet ose shkëmbimet që paguhen në lidhje me punësimin në Kosovë.

**Pagat e tatueshme** - pagat e paguara duke zbritur shumat e përjashtuara nga të ardhurat bruto nga pagat.

**Përfitimet në natyrë (po ashtu e njohur si përfitimet në gjësende)** – kompensimet e llojllojshme jo me pagë të dhëna të punësuarve përveç pagës apo rrogës së tyre normale. Të dhëna në mallra, artikuj apo shërbime se sa në para.

## **BAZA LIGJORE**

Neni 19, paragrafi 8, i Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, citojmë:

*“Për përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, tatimpaguesit i lejohet zbritje nga të ardhurat bruto për shpenzimet e bëra dhe të paguar brenda ose jashtë vendit, nëse ato janë bërë gjatë periudhës tatimore në tërësi dhe ekskluzivisht përkitazi me veprimtarinë e tij ekonomike dhe nëse ato janë të dokumentuara si shpenzime dhe pagesa të bëra”.*

Neni 23, paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2010 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, citojmë:

*“Sikurse është paraparë në legjislacionin tatimor përkatës, tatimpaguesit i lejohet të zbresë nga të ardhurat bruto ato shpenzime të paguara apo të ndodhura gjatë periudhës tatimore që lidhen me veprimtarinë ekonomike në atë periudhë nëse këto shpenzime në tërësi apo pjesërisht janë në lidhje me veprimtarinë ekonomike të kryer gjatë periudhës tatimore. Ngjashëm, një tatimpaguesi i lejohet një kreditim në një deklaratë tatimore në përputhje me legjislacionin e TVSh-së në fuqi.*

*Për tu lejuar shpenzimet/kreditimet e tilla, duhet të mbështeten me evidencë duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në sa vijon:*

- 1.1. faturat në të cilat duhet të paraqitet numri fiskal i shitësit/ofruesit
- 1.2. kontratat;
- 1.3. deklaratat e doganës, nëse janë të shoqëruara me dokumentacion që provon koston dhe pronësinë e artikullit(ujve) të importuar;
- 1.4. kuponët në të cilat duhet të paraqitet numri fiskal i shitësit/ofruesit;
- 1.5. dokumentet e pagesës;
- 1.6. dokumentet bankare;
- 1.7. regjistrimet e listës së pagave;
- 1.8. biletat;
- 1.9. dëftesat;
- 1.10. urdhër transferet;
- 1.11. dokumente tjera përkatëse”.

Neni 36, paragrafi 2, i Ligjit Nr. 03/L-146 për TVSh, citojmë:

“Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë Ligj, personi i tatueshëm mundë të zbres nga obligimet e tij të TVSH-së, obligimin e TVSH-së apo TVSH-në e paguar në lidhje me blerjet e mallrave dhe shërbimeve këtu e tutje: TVSH e zbritshme, me kusht që ai të ketë shfrytëzuar apo do të shfrytëzojë ato mallra ose shërbime për qëllime të transaksioneve të tij të tatueshme”.

Neni 15, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-161 për Tatim në të Ardhura Personale, citojmë:

“Në varësi të dispozitave të këtij neni, lejohen si zbritje nga të ardhurat e përgjithshme të krijuara nga pasuria e paprekshme, qiratë apo aktivitetet afariste shpenzimet e paguara ose të shkaktuara gjatë periudhës tatimore që janë tërësisht, vetëm dhe drejtpërdrejt të lidhura me aktivitetet e tilla që gjenerojnë të ardhura, përfshirë primet për sigurim shëndetësor, të paguara në interes të punëtorit dhe ato të varura që duhet të përfshihen në polisën e të punësuarit”.

Neni 30, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-161 për Tatim në të Ardhura Personale, citojmë:

“Nuk lejohet kurrfarë zbritje për:

- 1.1. Shpenzimet e përvetësimit të tokës;
- 1.2. Gjobat, dënimet, shpenzimet dhe interesi që lidhet me to, për çdo shkëlqje të ligjit apo procedurave administrative;
- 1.3. Tatimi në të ardhura të paguara apo të akruara (nuk përfshinë tatimet e mbajtura në burim nga të punësuarit);
- 1.4. Tatimi në Vlerën e Shtuar për të cilin tatimpaguesi kërkon zbritje ose kreditim për tatimin e zbritshëm në bazë të legjislacionit për Tatimin në Vlerën e Shtuar;
- 1.5. Shpenzimet personale, të jetesës ose ato familjare;
- 1.6. Çfarëdo humbje nga shitja ose këmbimi i pronës ndërmjet personave të afërm, dhe
- 1.7. Shpenzimet për dëfrim dhe rekreacion, përveç nëse kanë ndodhur në lidhje me afarizmin e tatimpaguesit që ofron aktivitetet për dëfrim dhe rekreacion;
- 1.8. Shpenzimet e pa dokumentuara sipas kërkesave të vendosura me një akt nënligjor të lëshuar nga ministri, do të konsiderohen si shpenzime të palejueshme.”

Neni 9, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-162 për Tatim në të Ardhura të Korporatave, citojmë:

*“Në varësi të kufizimeve të këtij Ligji, në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, tatimpaguesit i lejohet zbritje nga të ardhurat bruto të paguara ose të bëra vetëm gjatë periudhës tatimore në tërësi dhe ekskluzivisht përkitazi me veprimtarinë e tij ekonomike, përfshirë primet për sigurim shëndetësor, të paguara në interes të punëtorit dhe ato të varura që duhet të përfshihen në polisën e të punësuarit”.*

Neni 8, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-162 për Tatim në të Ardhura të Korporatave, citojmë:

*“1. Gjatë përcaktimit të të ardhurave të tatueshme shpenzimet e mëposhtme janë të palejueshme:*

- 1.1. Shpenzimet e përvetësimit dhe përmirësimit të tokës;*
- 1.2. Shpenzimet e përvetësimit, përmirësimit, ripërtërimit dhe rindërtimit të mjeteve të cilat janë kapitalizuar dhe zhvlerësuar ose amortizuar në bazë të dispozitave të këtij Ligji;*
- 1.3. Gjobat, ndëshkimin, shpenzimet dhe interesi që lidhet me to;*
- 1.4. Tatimi në të ardhura i paguar ose i lindur për periudhën tatimore aktuale ase të mëparshme dhe çdo interes ose ndëshkim i krijuar për pagese me vonese të tij;*
- 1.5. Tatimi në vlerën e shtuar për të cilin tatimpaguesi kërkon zbritje ose kreditim për tatimin e zbritshëm në bazë të legjislacionit për Tatimin në Vlerën e Shtuar;*
- 1.6. Çdo humbje nga shitja apo këmbimi i pasurisë në mes të personave të lidhur;*
- 1.7. Kontributet pensionale mbi shumën maksimale të lejuar nga ligji mbi pensionet në Kosovë.”*

## **TRAJTIMI I SHUJTAVE PËR TË PUNËSUARIT PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR - TVSH**

E drejta për të zbritur TVSh-në është e rregulluar përmes Nenit 36, Paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-146 për TVSh. Me këtë paragraf, janë përcaktuar kushtet për realizimin e të drejtës së zbritjes së TVSh-së së zbritshme, si në vijim:

*“... personi i tatueshëm mundë të zbres nga obligimet e tij të TVSh-së, obligimin e TVSh-së apo TVSh-në e paguar në lidhje me blerjet e mallrave dhe shërbimeve këtu e tutje: TVSh e zbritshme, me kusht që ai të ketë shfrytëzuar apo do të shfrytëzojë ato mallra ose shërbime për qëllime të transaksioneve të tij të tatueshme ...”.*

Pra, duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartpërmendur, me rastin e dhënies së përfitimeve në natyrë (shujtave për të punësuarit), nëse ato ofrohen për punëtorët të cilët janë të lidhur drejtpërdrejtë me realizimin e furnizimeve të tatueshme, do të lejohet e drejta e zbritjes së TVSh-së së zbritshme.

Po ashtu, e drejta e zbritjes së TVSh-së kur nga biznesi ofrohen furnizim i mallrave / shërbimeve të përziera, pra edhe furnizime të tatueshme edhe furnizime të liruara, është e rregulluar përmes Nenit 36, Paragrafit 4 të të njëjtit Ligj, si në vijim:

*“Për mallrat dhe shërbimet e shfrytëzuara ose që do të shfrytëzohen nga një person i tatueshëm, që të dyja për transaksionet e mbuluara nga paragrafi 2 dhe 3 të nenit 36 këtij ligji, për të cilat mundë të zbritet TVSH dhe për transaksionet për të cilat TVSH nuk duhet të zbritet, mundë të zbritet vetëm ajo pjesë e TVSH-së që i atribuohet transaksionit të parë”.*

Pra, duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartpërmendur, me rastin e dhënies së përfitimeve në natyrë (shujtave për të punësuarit), nëse ato ofrohen për punëtorët të cilët janë të lidhur drejtpërdrejtë me realizimin e furnizimeve të përziera, do të lejohet e drejta e zbritjes së TVSh-së së zbritshme vetëm për aq sa i takon furnizimeve të tatueshme.

Gjithashtu, duhet nënkuptuar se në rastet e dhënies së përfitimeve në natyrë (shujtave për të punësuarit), nëse ato ofrohen për punëtorët të cilët janë të lidhur drejtpërdrejtë me realizimin e furnizimeve të liruara, nuk do të lejohet e drejta e zbritjes së TVSh-së së zbritshme.

Bazuar në sqarimet e mësipërme, tatimpaguesit i lejohet të shfrytëzojë TVSh-në e zbritshme për të gjitha blerjet në lidhje me mallrat apo shërbimet nëse ato janë në funksion të shitjeve të tatueshme.

Prandaj, kur organizimi i ushqimit për punëtor brenda biznesit është krejtësisht në funksion të afarizimit që ka për qëllim të mundësojë furnizimet e tatueshme, TVSh e ngarkuar dhe paguar në blerjet në lidhje me sigurimin e ushqimit për punëtor brenda biznesit, lejohet si TVSh e zbritshme.

Nëse punëtorët zgjedhin vetë të ushqehen jashtë kompanisë dhe nga punëdhënësi kërkojnë që të rimbursojnë faturat e ushqimit, atëherë ofrimi i ushqimit në këto raste trajtohet si përfitim personal i punëtorit. Në këto raste nuk njihet kreditimi i TVSh-së për ushqimin që iu është ofruar atyre punëtorëve.

## **TRAJTIMI I SHUJTAVE PËR TË PUNËSUARIT PËR TAP dhe TAK**

Trajtimi tatimor i shujtave për të punësuarit është i rregulluar me Nenin 9, paragrafin 2.4, të Ligjit Nr. 03/L-161 për TAP.

Në të ardhurat e përgjithshme nga pagat **nuk** përfshihen :

*“Përfitimet në natyrë në forma të shujtave të ofruara nga punëdhënësi për punëtorin duke përfshirë kompensimin në para”.*

Dispozita e mësipërme përcakton se përfitimi në natyrë në formë të shujtave të ofruara nga punëdhënësi për përfituesin (të punësuarin), nuk konsiderohet e ardhur nga paga.

Ndërsa, paragrafi 2.7 i të njëjtit nen, thekson:

*“Rimbursimi i tillë apo dhënia e përfitimeve në natyrë nuk do të konsiderohen si shpenzime të zbritshme biznesi nga ndonjë dhurues i rimbursimit të tillë apo përfitimeve në natyrë, e as nuk do të jenë të zbritshme si shpenzim të ndonjë lloji”.*

Bazuar në paragrafin e mësipërm, kur të punësuarit ushqehen jashtë kompanisë si të pavarur dhe tek punëdhënësi ofrojnë faturat e ushqimit për t'i rimbursuar, faturat e tilla nuk do të njihen si shpenzim i kompanisë nëse ato janë rimbursuar.

Në varësi të kufizimeve të Ligjit për Tatim në të Ardhura Personale dhe Ligjit për Tatim në të Ardhura të Korporatave, në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, tatimpaguesit kanë të drejtë të zbresin të gjitha shpenzimet të cilat janë krijuar me qëllim të ushtrimit të aktivitetit ekonomik, duke përfshirë edhe shujtat e ushqimit që përcaktohen me politikën afariste të biznesit.

## PËRFUNDIM

E drejta e zbritjes së TVSh-së së zbritshme do të lejohet vetëm me rastin e dhënies së përfitimeve në natyrë (shujtave për të punësuarit), qoftë të ofruar përmes mensës në kuadër të biznesit apo blerjes së ushqimit nga ndonjë biznes i cili ofron ushqim të gatshëm, nëse ato ofrohen për punëtorët të cilët janë të lidhur drejtpërdrejtë me realizimin e furnizimeve të tatueshme.

Gjithashtu, për çështje të tatimeve direkte (TAP dhe TAK), tatimpaguesit kanë të drejtë të njohin shpenzim shujtat e ofruara për të punësuarit, të cilat janë krijuar në funksion të ushtrimit të aktivitetit ekonomik.

## HYRJA NË FUQI

Ky Vendim Shpjegues Publik hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së.

Data: 25/11/2014

Prishtinë

Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së

  
(Behxhet Haliti)

